

Vendim nr. 247 datë 24.10.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Illir Toska,	Anëtar
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 24.10.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 15 (M) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: **MARJETA LACAJ**

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-1158 (116), datë 25.03.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Marjeta Lacaj në datën 01.08.2013 është konfirmuar si nëpunëse civile në periudhë prove në pozicionin “specialiste”, në Sektorin e Shërbimeve Sociale dhe Administrative në Drejtorinë e Menaxhimit dhe Monitorimit të Buxhetit në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave (MF). Me urdhrin nr. 179, datë 18.10.2013 të Kryeministrit është miratuar struktura dhe organika e re e MF-së. Në bazë të këtij urdhri, sekretari i përgjithshëm i MF-së, me shkresën nr. 16967 prot., datë 08.11.2013, ka njoftuar kërkuesen për kalimin në listëpritje, e cila është miratuar nga Departamenti i Administratës Publike (DAP) me shkresën nr. 1650/3 prot., datë 26.11.2013, miratim për të cilin ajo është njoftuar me shkresën nr. 16967/1 prot., datë 09.12.2013 të sekretarit të përgjithshëm të MF-së. Në vijim, ky i fundit, me shkresën nr. 16967/2 prot., datë 09.12.2013, ka miratuar kalimin në listëpritje të kërkueses.

2. Në datën 11.03.2015 kërkuesja i është drejtuar gjykatës me padi, duke kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të akteve nr. 16967 prot., datë 08.11.2013 dhe nr. 16967/1 prot., datë 09.12.2013 të sekretarit të përgjithshëm të MF-së, rikthimin në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion tjetër në strukturën e re, si dhe detyrimin e MF-së për pagimin e pagës së plotë nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare dhe deri në rikthimin e saj në punë.

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2084, datë 20.04.2015, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, si të pabazuar në ligj dhe në prova. Sipas asaj gjykate, ndryshe nga sa pretendon paditësja (kërkuesja), ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin Civil” (ligji nr. 152/2013) nuk ka qenë ligji i zbatueshëm në çastin e nxjerrjes së akteve administrative objekt shqyrtimi gjyqësor, por i tillë ka qenë ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “Për statusin e nëpunësit civil” (ligji nr. 8549/1999). Po sipas saj, akti administrativ që kundërshtohet është në formën shkresore të kërkuar nga ligji, ndërsa është respektuar edhe procedura e parashikuar nga ligji për nxjerrjen e tij, e cila ka filluar me njoftimin e paditëses për kalimin në listëpritje, njoftimin e miratimit të kalimit në listëpritje dhe njoftimin për vendimin e miratimit të kalimit në listën e pritjes. Kundër këtij vendimi kërkuesja ka paraqitur ankim në gjykatën e apelit.

4. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1401 (86-2017-1402), datë 05.04.2017, ka ndryshuar vendimin e gjykatës administrative të shkallës së parë, duke vendosur pranimin e kërkesëpadisë, sipas objektit të saj. Ajo gjykatë ka arsyetuar se kërkuesja është larguar nga Shërbimi Civil në një periudhë kur kishte hyrë në fuqi ligji nr. 152/2013, ndaj procedurat që duheshin ndjekur në rastin e saj janë ato sipas këtij ligji. Lidhur me këtë, gjykata

e apelit ka vërejtur se neni 72 i ligjit nr. 152/2013 ka përcaktuar hyrjen në fuqi të ligjit në datën 01.10.2013, ndërkohë që me aktin normativ nr. 5, datë 30.09.2013 të Këshillit të Ministrave (*akti normativ nr. 5/2013*) kjo dispozitë u ndryshua, duke përcaktuar se ligji hynte në fuqi në datën 01.10.2013, ndërsa efektet e tij fillonin 6 muaj pas hyrjes në fuqi dhe se deri në datën e fillimit të efekteve zbatohet ligji nr. 8549/1999. Megjithatë akti normativ në fjalë u shfuqizua me vendimin nr. 5, datë 05.02.2014 (*vendimi nr. 5/2014*) të Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*). Për rrjedhojë, sipas gjykatës së apelit, në analizë edhe të përmbajtjes së nenit 76 të ligjit nr. 8577/2000, shfuqizimi i aktit normativ ka sjellë si pasojë që efektet e ligjit nr. 152/2013 të nisnin që nga data e hyrjes në fuqi të tij, ndaj në rrethanat kur ky ligj ka hyrë në fuqi më 01.10.2013, edhe situata faktike juridike në rastin në shqyrtim rregullohet nga dispozitat e tij. Për sa i përket themelit të çështjes, gjykata e apelit ka arritur në përfundimin se aktet administrative objekt padie janë absolutisht të pavlefshme, duke vlerësuar se neni 50 i ligjit nr. 152/2013 nuk parashikon mundësinë e nxjerrjes në listëpritse të nëpunësit civil dhe as kompetencën e sekretarit të përgjithshëm të ministrisë përkatëse për nxjerrjen e një urdhri të tillë, ndaj, sipas saj, pala e paditur ka pasur detyrimin për të sistemuar paditësen në një vend tjetër pune. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar rekurs palët e paditur MF-ja dhe DAP-i.

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1158 (116), datë 25.03.2024, në dhomën e këshillimit, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Sipas Gjykatës së Lartë, vendimi i gjykatës së apelit është marrë në zbatim të gabuar të ligjit material dhe procedural, pasi i ka dhënë fuqi prapavepruese ligjit nr. 152/2013. Ajo ka arsyetuar se aktet objekt gjykimi kanë dalë në zbatim të ligjit nr. 8549/1999, ndaj, për rastin në shqyrtim, gjykata ka qenë e detyruar të zgjidhte çështjen mbi ligjin që vepronte në kohën e lindjes së mosmarrëveshjes, pikërisht mbi ligjin nr. 8549/1999. Në vijim, sipas asaj gjykate, vendimi i Gjykatës ka hyrë në fuqi në datën 26.02.2014, kohë kur çështja objekt shqyrtimi nuk ishte ngritur ende, ndërsa kërkesëpadia është paraqitur në datën 11.03.2015, ku nisur nga kjo vendimi i Gjykatës nuk mund të sjellë efekte në këtë rast, referuar për këtë neni 76 të ligjit nr. 8577/2000, sipas të cilit vendimi i kësaj gjykate ka fuqi prapavepruese vetëm ndaj çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat, derisa vendimet e tyre nuk kanë marrë formë të prerë. Pra, efektet juridike të vendimit të Gjykatës do të gjenin zbatim vetëm në rastin nëse çështja objekt shqyrtimi do të ishte në proces gjyqësor dhe për të cilin ende nuk do të kishte një vendim të formës së prerë.

6. Në datën 25.07.2024 kërkuësja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit, ankim i cili, pas plotësimit të tij, është regjistruar përfundimisht në datën 01.08.2024. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore e anëtarëve të Gjykatës, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuësës

7. **Kërkuësja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë është rrjedhojë e një procesi të jo rregullt ligjor në drejtim të *parimit të sigurisë juridike*, pasi vendimi është marrë në shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenet 132 dhe 145 të Kushtetutës. Ajo gjykatë nuk ka respektuar vendimin nr. 5/2014 të Gjykatës, ndërsa ka zbatuar aktin normativ nr. 5/2013, i cili është shfuqizuar si antikushtetues, çka përbën shkelje të integritetit të sistemit juridik. Në vendimin e asaj gjykate vërehet mungesa e qartësisë për të kuptuar ndryshimin thelbësor midis një ligji të shfuqizuar për shkak të hyrjes në fuqi të ligjit të ri dhe një ligji të shfuqizuar për shkak të shpalljes, si të papajtueshëm me Kushtetutën. Në respektim të parimit *tempus regit actum*, në rastin konkret, ligji i zbatueshëm është ai nr. 152/2013, ndërkohë që vendimi nr. 5/2014 i Gjykatës ka efekt prapaveprues në këtë rast, referuar ligjit nr. 8577/2000, pasi rregulli, sipas të cilit vendimi i Gjykatës ka fuqi prapavepruese vetëm për çështjet që shqyrtohen nga gjykatat, derisa vendimet e tyre nuk kanë marrë formë të prerë, synon të përcaktojë se një marrëdhënie ose situatë juridike apo faktike, nuk mund të shqyrtohet nga gjykatat bazuar në një dispozitë ligjore që nuk është në pajtim me Kushtetutën.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuësës

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person

fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

9. Në këtë këndvështrim, Kolegji vlerëson se kërkesja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, sepse është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

10. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, kërkesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm, duke parashtruar pretendime për vendimin e Gjykatës së Lartë, për rrjedhojë Kolegji vlerëson se ajo nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual (*shih vendimet nr. 24, datë 11.10.2022; nr. 35, datë 01.11.2021; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Kolegji vëren se vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar nga kërkesja, mban datën 25.03.2024, por sipas informacionit të dërguar nga Gjykata e Lartë ky vendim është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 23.04.2024, datë nga e cila palët mund të njiheshin me përmbajtjen e tij. Për rrjedhojë, paraqitja e ankimit kushtetues individual në datën 25.07.2024 është brenda afatit ligjor 4-mujor.

12. Në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae*, kërkesja ka pretenduar se vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë është rrjedhojë e një procesi të jo rregullt ligjor në drejtim të parimit të sigurisë juridike, pasi ai vendim është marrë në shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenet 132 dhe 145 të Kushtetutës. Sipas kërkeses, ajo gjykatë nuk ka respektuar vendimin nr. 5/2014 të Gjykatës, ndërsa ka zbatuar aktin normativ nr. 5/2013, i cili është shfuqizuar si antikushtetues, çka përbën shkelje të integritetit të sistemit juridik. Në vendimin e asaj gjykate, vijon kërkesja, vërehet mungesë qartësie për të kuptuar ndryshimin thelbësor midis një ligji të shfuqizuar për shkak të hyrjes në fuqi të ligjit të ri dhe një ligji të shfuqizuar për shkak të

shpalljes, si të papajtueshëm me Kushtetutën. Sipas saj, në respektim të parimit *tempus regit actum*, në rastin konkret, ligji i zbatueshëm është ai nr. 152/2013, ndërkohë që vendimi nr. 5/2014 i Gjykatës ka efekt prapaveprues, në këtë rast referuar ligjit nr. 8577/2000, pasi rregulli, sipas të cilit se vendimi i Gjykatës ka fuqi prapavepruese vetëm për çështjet që shqyrtohen nga gjykatat, derisa vendimet e tyre nuk kanë marrë formë të prerë, synon të përcaktojë se një marrëdhënie ose situatë juridike apo faktike, nuk mund të shqyrtohet nga gjykatat bazuar në një dispozitë ligjore që nuk është në pajtim me Kushtetutën. Kolegji vëren se pretendimet e kërkueses, në thelb, kanë të bëjnë me mënyrën se si Gjykata e Lartë ka arsyetuar në rastin e saj në lidhje me ligjin e zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, e lidhur kjo edhe me zbatimin e nenit 76 të ligjit nr. 8577/2000 në drejtim të efekteve të vendimit nr. 5/2014 të Gjykatës.

13. Gjykata ka theksuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo Gjykatë nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Kolegji vëren se ligji nr. 152/2013 është miratuar nga Kuvendi në datën 30.05.2013 dhe sipas nenit 72 të tij ai hynte në fuqi në datën 01.10.2013. Këshilli i Ministrave ka miratuar aktin normativ nr. 5, datë 30.09.2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil””, i cili ka hyrë në fuqi menjëherë dhe është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 159, datë 30.09.2013. Akti normativ ka ndryshuar nenet 70 dhe 72 të ligjit nr. 152/2013, duke parashikuar se ligji hyn në fuqi në datën 01.10.2013 dhe i fillon efektet 6 muaj pas hyrjes në fuqi e se deri në datën e fillimit të efekteve të tij do të zbatohet ligji nr. 8549/1999. Për rrjedhojë, në kohën kur janë nxjerrë aktet administrative të kundërshtuara nga kërkuësja (në datat 08.11.2013 dhe 09.12.2013) kanë qenë të zbatueshme parashikimet e ligjit nr. 8549/1999, për sa kohë që ligji i ri nr. 152/2013 nuk kishte filluar ende efektet.

15. Me vendimin nr. 5/2014, Gjykata ka vendosur shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të aktit normativ të Këshillit të Ministrave nr. 5/2013, vendim që ka hyrë në fuqi

në datën 26.02.2014, në përputhje me parashikimet e nenit 132 të Kushtetutës, pas botimit në Fletoren Zyrtare. Sipas nenit 76 të ligjit nr. 8577/2000, në rastet kur Gjykata shfuqizon një ligj ose akt normativ, si të papajtueshëm me Kushtetutën, vendimi i saj, si rregull, sjell efekte juridike nga data e hyrjes së tij në fuqi, dhe se ka fuqi prapavepruese vetëm ndaj çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat, derisa vendimet e tyre nuk janë përfundimtare dhe të formës së prerë (pika 7, shkronja “b”).

16. Kolegji, referuar akteve bashkëlidhur kërkesës, si dhe përmbajtjes së vendimeve gjyqësore, konstaton se kërkuësja i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi në datën 11.03.2015, pra pas hyrjes në fuqi të vendimit të Gjykatës. Për rrjedhojë, sikurse Gjykata e Lartë është shprehur, për sa kohë që në momentin që ka hyrë në fuqi vendimi i kësaj Gjykate, çështja e kërkuësjes nuk ka qenë në shqyrtim përpara gjykatave të zakonshme, ky vendim nuk mund të sillte efekte në atë çështje.

17. Bazuar në sa më sipër, Kolegji vlerëson se Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me kompetencat e saj, duke interpretuar dispozitat e zbatueshme, në rastin konkret, në këndvështrim të rrethanave konkrete të çështjes, me qëllim identifikimin e ligjit të zbatueshëm nga gjykata për zgjidhjen e mosmarrëveshjes konkrete. Në kundërshtim me sa pretendon kërkuësja, interpretimi i Gjykatës së Lartë, në rastin konkret, jo vetëm nuk duket që të jetë arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm, por ajo gjykatë, në mënyrë të plotë, ka parashtruar në vendimin e saj të gjitha argumentet mbi bazën e të cilave ka arritur në përfundimin e paraqitur në dispozitiv.

18. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkuësjes janë haptazi të pabazuara, ndaj ato nuk mund të merren në shqyrtim.

19. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.